

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetari i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.K., nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës, M.D. , nga fshati ..., Komuna e Lipjanit dhe F.P. ,nga fshati ..., Komuna e Gllogocit për shkak të veprave penale të kryera në bashkëkryerje: Vjedhje e rëndë në tentativë, nga neni 327 par 2 nën par 2.7 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së dhe në bashkëkryerje Keqpërdorimi i besimit, nga neni 342 par 2 lidhur me par 1 si dhe me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, P.nr.342/2013, datë 19.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.03.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, P.nr.342/2013, datë 19.11.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc , me aktgjykimin P.nr.342/2013, datë 19.11.2018, të akuzuarit F.K., M.D. dhe F.P. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale nga dispozitivi I të aktgjyqimit Vjedhje e rëndë në tentativë, nga neni 327 par 2 nën par 2.7 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, ku i ka gjykuar secilin veç e veç me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nga 2 (dy) viteve. Për veprën penale nga dispozitivi II i aktgjyqimit të ankimuar në bashkëkryerje Keqpërdorimi i besimit, nga neni 342 par 2 lidhur me par 1 si dhe me nenin 31 të KPRK-së ku i ka gjykuar secilin veç e veç me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Në bazë të nenit 80 par. 1 lidhur me par. 2 nën par. 2.2 të KPRK-së, gjykata i ka shqiptuar dënim unik të kushtëzuar me burgim, ashtu që të akuzuarve F.K., M.D. dhe F.P. secilit veç e veç i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nga 2 vite e 4 muaj, në të njëjtën kohë ka urdhëruar që këto dënime mos të ekzekutohen nëse të akuzuarit në afat prej 3 viteve nuk kryejnë vepër tjetër penale. E dëmtuara Kompania “NN” me seli në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar ta realizoj në kontest të rregullt juridiko civil. Janë detyruar të akuzuarit, secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën

prej 50 € dhe për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Të akuzuarit janë obliguar secili veç e veç, për programin për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë taksën në shumë prej 30 €, këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për shkak vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën e të njëjti ta aprovoj si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që të akuzuarve t'iu shqiptoj dënim me burgim efektiv.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr182/2019, datë 21.02.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarve t'iu shqiptohet dënim me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk animohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarve.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Sa i përket vendimit për dënim, Prokurori në ankesë pretendon se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike por vendimin mbi sanksionin penal është i butë, ngase për veprat penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtorë sipas dispozitave ligjore parashihet dënim më i ashpër, ndërsa në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë ligjor për këto vepra penale. Po ashtu prokurori me rastin e shqiptimit të dënim me kusht gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh, mirëpo rrethanat lehtësuese i

ka mbivlerësuar sikurse që është pranimi i fajësisë së të akuzuarve, ndërsa nuk ka vlerësuar faktin se kemi të bëjmë me dy vepra penale që janë kryer me dashje direkte, me marrëveshje paraprake dhe të njëjtit ishin të vetëdijshëm mbi veprimet e tyre të ndërmarra inkriminuese dhe të gjitha këto veprime janë ndërmarrë me qëllim që vetit ti sjellin përfitime pasurore të kundërligjshme. Prokurori konsideron se me dënime të tilla të shqiptuar të akuzuarve nuk do të arrihet qëllimi i dënimit dhe ekziston mundësia që të njëjtit ti përsërisin veprimet e tilla, ashtu që më shqiptimin e dënimit adekuat do të arrihet parandalimi i kryesve të këtyre veprave penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të prokurorit , për ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar në atë mënyrë që të akuzuarve t’iu shqiptohet dënim më i ashpër-dënim me burgim efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 73 të KPRK-së, i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç’ rast për të akuzuarit, si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh faktin se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, nuk ka të dhëna se janë dënuar më parë, se nuk ka të dhëna se ndaj tyre zhvillohet procedurë tjetër penale, gjykatës i kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të tjera penale, se pendohen për veprat e kryer penale, kanë kërkuar falje, janë kryefamiljar dhe mbajtës të familjeve të tyre, të martuar i akuzuari F.K. dhe F.P. janë prindër secili nga tre fëmijë të mitur, kurse i akuzuari M.D. baba i një fëmije të mitur, ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarit gjykata e shkallës së parë ka gjetur shkallën e lartë të dashjes së të akuzuarve gjatë kryerjes së veprave penale. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe vlerëson se dënimet e shqiptuar të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë të drejta dhe në pajtim me dispozitat ligjore. Rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e prokurorit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të asaj rëndësie që të ndikojnë në shqiptimin e dënimeve tjera nga ato të cilat ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, pastaj duke marrë për bazë mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e me qenë se në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë e re rënduese, e cila kishte me pas ndikim në shqiptimin e një dënimi më të ashpër, e posaçërisht duke marrë parasysh faktin e pranimin të fajësisë për kryerjen e veprave penale nga ana e të akuzuarve, andaj, nga të gjitha këto, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tyre dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarve nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.162/19, datë 12.03.2019

Zyrtarit ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Biljana Rexhiq